



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

DEKLARATË
PËR CILËSINË E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË QENDRËS SË
SHËRBIMEVE ARSIMORE PËR VITIN 2021

Unë e nënshkruara **Aurora Balliu**, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiare të njësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i MASR, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 10296, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ne cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Qendrës së Shërbimeve Arsimore gjatë vitit raportues 2021, nëpërmjet vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit në veçanti, bazuar në orientimet e Kapitujve II dhe III të Manualit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr.54 date 15.07.2010. Metoda që është përdorur për monitorimin e komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë nëpërmjet raportit për funksionimin e sistemit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është raportuar tek titullar i MASR dhe është diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Nënshkruar nga:

Aurora BALLIU
NEPUNES AUTORIZUES
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE